

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët–Valdete Daka, kryetare, Nesrin Lushta e Salih Toplica-anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit L. F. nga Kamenica, për shkak të veprës penale hyrja në sistemet kompjuterike nga neni 339.par.1. lidhur me nenin 31. të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligshmërisë të dënuarit dhe mbrojtësit të tij të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan P.nr.478/2013 të datës 21.06.2015. dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.881/2015 të datës 06.10.2015., në seancën e mbajtur më 12.05.2016., mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligshmërisë të dënuarit L. F. dhe të mbrojtësit të tij, anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan P.nr.478/2013 i datës 21.06.2015. dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.881/2015 i datës 06.10.2015. dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan P.nr.478/2013 të datës 21.06.2015. i dënuari L. F. është shpallur fajtor për veprën penale hyrja në sistemet kompjuterike nga neni 339.par.1. lidhur me nenin 31. të KPK dhe është gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 250 (dyqindpesëdhjet) euro të cilin është obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit e në rast të mos pagimit i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur 20 euro për një ditë burgimi. Është obliguar të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, ndërsa për realizimin e kërkesë pronësoro juridike e dëmtuara është udhëzuar në kontestin civil.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit të Kosovës ka marr aktgjykimin PA1.nr.881/2015 të datës 06.10.2015. me të cilin janë refuzuar ankesat e paraqitura ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë të përbashkët për mbrojtën e ligjshmërisë kanë paraqitur i dënuari dhe mbrojtësi i tij avokati E. C. nga Kamenica, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 385.par.1.4.të KPPK dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale nga neni 384.par.1.pika 1.6. dhe par.2.1.KPPK, me propozim që të ndryshohen dhe i dënuari të lirohet nga akuza ose të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim si dhe të shtyhet ekzekutimi i dënimit të shqiptuar.

Prokurori i shtetit me parashtresën KMLP.II.nr.42/16 të datës 08.03.2016. ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435. par. 1. lidhur me nenin 436. par. 1. të KPPK, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatojë se:

-kërkesa është e bazuar.

Në kërkesë pretendohet se në aktgjykimet e kundërshtuara si koha e kryerjes së veprës penale është shënuar data 12.08.2013., e cila nuk është e saktë sepse vepra penale është kryer në datën 12.08.2012. e pasi i dënuari është i lindur më datën “data e lindjes...” në atë kohë ka qenë i moshës së mitur. Andaj, ndaj tij duhej të udhëhiqej procedura për të mitur dhe janë bërë shkeljet e lartë cekura esenciale të dispozitave të procedurës penale kur është gjykuar si madhor dhe i është shqiptuar dënimi për madhor.

Gjykata Supreme konstatojë se nga të gjitha shkresat e lëndës, e sidomos kallëzimi penal i Policisë së Kosovës, raporti i njësisë së hetimeve të Stacionit policor në Kamenicë, datat kur janë marrë deklaratat e personave në polici, më pa mëdyshje del se koha e kryerjes së veprës penale është data 12.08.2012. por në aktakuzë dhe në aktgjykimet e kundërshtuara është shënuar data 12.08.2013. Pasi që sipas këtyre

shkresave data e kryerjes së veprës penale është 12.08.2012. ndërsa i mituri, sipas shënimeve që i ka dhënë, është i lindur më “data e lindjes...”. rezulton se në atë kohë ka pas ... vjet, ... muaj e ... ditë, andaj ka qenë i moshës së mitur.

Gjykata Supreme konstaton se duke udhëhequr procedurë penale për ekzekutorin e moshës madhore, në aktgjykimet janë bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384.par.2.të KPPK, sepse në këtë rast gabimisht janë zbatuar dispozitat e Kodit të procedurës Penale të Kosovës në vend që të aplikohen dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur i cili parasheh procedurën përgatitore, përbërjen tjetër të trupit gjykues, sanksione të veçanta që mund ti shqiptohen të miturit e tj. Në këtë mënyrë është bërë shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale e cila ka ndikuar në marrjen e vendimit të ligjshëm, siç me vend pretendohet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Për këto arsye, me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë u vendos që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje. Në gjykimin e serishëm duhet të sigurohet certifikata e lindjes ose ndonjë dokument tjetër për të vërtetuar datën e saktë e lindjes së të dënuarit, të shënohet data e saktë e kryerjes së veprës penale dhe në rast se nuk ka dyshim se i dënuari në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i moshës së mitur, pasi të udhëhiqet procedura për të mitur, të merret vendim i ligjshëm.

Nga këto arsye konform nenit 438. par.1.2. të KPPK u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pml.nr. 65/2016, më 12.05.2016.

Proçesmbajtësja,
Mirlinda Mejzini

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka